



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2480, datë 15.05.2014

Për

“Miratimin e përfundimit të këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)” dhe propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të tyre”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj.Iris Xhanaj, në mbledhjen e datës 05.05.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e përfundimit të këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)” dhe propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të tyre”.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
2. Pika 10 e nenit 5, shkronja g) dhe gj) të nenit 8, pika 2 e nenit 65, neni 68, dhe neni 69 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*), i ndryshuar;
3. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.

4. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP-it Nr.2426, datë 04.03.2014 për “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)”.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Relacioni përkatës;
- Propozimi i hartuar nga grupi i punës
- Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

Dokumentacioni për “Miratimin e përfundimit të këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)” dhe propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të tyre” është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

- përfundimet e këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)”;
- propozimin e AKEP për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të frekuencave në brezat 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT), Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP-it Nr.2426, datë 04.03.2014 për “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)”.

V E N D O S:

1. Të miratojë **përfundimin e këshillimit publik** “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)”, dhe të publikojë mendimet dhe komentet e palëve të interesuara, duke respektuar konfidencialitetin e informacionit, si dhe

qëndrimin e AKEP për çështjet e ngritura sipas dokumentit bashkëlidhur;

2. Të miratojë propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të frekuencave në brezat 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)", sipas dokumentit bashkëlidhur;

2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Alketa MUKAVELATI** _____
3. **Benon PALOKA** _____
4. **Zamira NURÇE** _____

Komentet e pjesemarrësve ne keshillimin publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)”

Në zbatim të shkronjes g) dhe gj) te nenit 8, te nenit 65, te nenit 68, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*), i ndryshuar, 4. Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it Nr.2426, datë 04.03.2014 për “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)”, AKEP kreu nje keshillim public me palet e interesuara.

Ne perfundim te ketij keshillimi publik, ne AKEP u depozituan kater komente nga pale te interesuara.

Me poshte paraqiten komentet e te interesuarve duke ruajtur konfidencialitetin dhe qendrimi perkates i AKEP.

AKEP kishte propozuar ndarjen e meposhtme te spektrit:

Të drejtat e përdorimit	Sasia e spektrit
A	2x5 MHz spektër i çiftuar, 1965 -1970 MHz çiftuar me 2155-2160 MHz
B	2x5 MHz spektër i çiftuar 1970-1975 MHz çiftuar me 2160-2165 MHz
C	2x5 MHz spektër i çiftuar 1975-1980 MHz çiftuar me 2165-2170 MHz
D	5 MHz spektër i paçiftuar 1915-1920 MHz

1- Per pyetjen 1 te AKEP:

A jeni dakort me ndarjen e propozuar nga AKEP?

OPERATOR 1: Eshte dakort ne lidhje me alokimin e propozuar nga AKEP te sasise se spektrit ne brezat 1965-1980 MHz, ciftuar me 2155-2170 MHz dhe te paciftuar 1915-1920 MHz, 2x15 MHz spekter i ciftuar dhe 5 MHz spekter i paciftuar, sic jemi shprehur dhe ne konsultimin e meparshem publik ne lidhje me kete ceshtje te zhvilluar gjate periudhes 25.10.2013-04.12.2013. Ndarja e spektrit (per me shume se nje te drejte perdorimi) dhe te drejtat qe do te jepen duhet te reflektojne kapacitet teknike dhe financiare te operatoreve ne baze te sherbimeve dhe numrit te abonenteve qe ata zoterojne, ne menyre qe sasia e spektrit te disponueshem te perputhet me kapacitetet e cdc operatori, pasi operatoret kane kerkesa te ndryshme per spekter. Ligji 9918/2008 parashikon se nje nga qellimet rregullatore thelbesore te veprimtarise se AKEP eshte administrimi i spektrit te radio frekuencave per te garantuar eficence ne perdorim. Ne lidhje me kete,

Operator 1 mendon se ndarja e brezit sipas parashikimit te AKEP ne dokumentin per konsultim publik ka synim perdorimin me eficient te spektrit ne kete brez.

Ne praktikate e deritanishme, AKEP per dhenien dhe administrimin e spektrit ka mbajtur parasysh ndarjen e barabarte te spektrit ndermjet kater operatoreve celulare.

Pavaresisht kesaj, per te garantuar perdorimin eficient te spektrit, si dhe mosdiskriminim ndermjet operatoreve, AKEP duket se po merr parasysh nevojat per spekter per te garantuar cilesine e sherbimit qe klientet presin, si rezultat final i ofrimit te sherbimit. Bazuar ne raportet statistikore te publikuar nga AKEP si dhe zhvillimin e tregut ne Shqiperi duket se numri i klienteve dhe trafikut te gjeneruar nga klientet e secilit operator nuk eshte i njejte per te gjitha operatoret. Kjo tregon qarte se nevojat per spekter nuk jane te njejta per te gjitha operatoret. Disa operatore me numer me te madh perdoruesish rrjedhimisht edhe me gjenerim trafiku me te larte kane nevojte me shume per spekter. Keshtu AKEP me kete propozim duket se nuk do te leshoje vetem nje autorizim, por do t'i jape mundesi edhe operatoreve te vegjel edhe atyre te medhenj te blejne aq sasi spektri sa ju nevojitet. Ne kete menyre, operatoret e vegjel mund te blejne aq sasi spektri sa kane nevojte dhe operatoret e medhenj kane mundesi te blejne me shume spekter per te permiresuar cilesine e sherbimit. Nga analiza e praktikave ne vendet e tjera ne lidhje me dhenien e radio frekuencave ne brezin IMT, rezulton se shumica e vendeve e kane ndare brezin ne pjese prej 5 MHz duke iu dhene mundesine te gjitha operatoreve te marrin pjese dhe te paraqesin ofertat e tyre sipas vleres qe secili prej tyre do t'i jepte spektrit. Ne baze te parimeve dhe objektive te Ligjit per komunikimet elektronike, ndarja e spektrit duhet te jete sa me efektive ndermjet operatoreve, ne perputhje me nevojat e tyre.

OPERATOR 2 shprehet se Ligji 9918/2008 parashikon se nje nga qellimet rregullatore thelbesore te veprimtarise se AKEP eshte administrimi i spektrit te radio frekuencave per te garantuar eficence ne perdorim. Ne lidhje me kete, Operator 2 mendon se rindarja e brezit sipas parashikimit te AKEP ne dokumentin per konsultim publik sipas VKD 2426/4.3.2014, ne ndryshim nga VKD 2370/18.10.2013, garanton perdorim me eficient te spektrit ne kete brez. Ne vijim, per te garantuar zbatimin e Ligjit 9918/2008 dhe perdorimin eficient te spektrit, sic edhe jemi shprehur ne menyre te perseritur, AKEP duhet te marre parasysh nevojat proporcionale per spekter per te garantuar

cilesine e shërbimit, nevoja të cilat nuk janë të njëjta për të gjithë operatorët. Në këtë kuader, propozimi i ri i AKEP në VKD nr. 2426 gjen mbështetje dhe në praktiken në vendet e tjera në lidhje me dhenien e radio frekuencave në brezin IMT, ku rezultojnë shumica e vendeve të kane ndarë brezin në pjesë prej 5 MHz dhe të kane organizuar dhenien e spektrit në tendera me disa raste, ku të gjithë operatorët mund të marrin pjesë dhe të paraqesin ofertat e tyre sipas vlerës që secili prej tyre do t'i jepte spektrit. Ndaj dhe Operator 2 është dakord me ndarjen e brezit dhe dhenien e disa të drejtave për përdorim të spektrit dhe shpërndarjen në mënyrë sa më efektive ndërmjet operatorëve, në përputhje me nevojat e tyre.

Për sa më lart, Operator 2 mbështet ndarjen e brezit në pjesë prej 5 MHz secila (tre blloqe me nga 2x5 MHz si pjesë spektri të çiftuara dhe një bllok prej 5 MHz si pjesë e paciftuar spektri dhe dhenien e me shumë se një të drejtë përdorimi. Në këtë mënyrë, operatorët e vegjël mund të blejnë aq sasi spektri sa kane nevojë dhe operatorët e mëdhenj kane mundësi të blejnë me shumë spekter për të përmirësuar cilësinë e shërbimit.

OPERATOR 3: Propozimi i AKEP me Vendimin nr. 2426, datë 04.03.2014 ("Vendimi"), nga një anë, krijon hapësirën për të shpallur hapjen e një tenderi publik ku mund të marrin pjesë të gjithë operatorët - pavarësisht faktit nëse kane apo jo Autorizim përdorimi për shërbimin 3G dhe nga ana tjetër, propozon mundësinë e dhenies së me shumë se një të drejtë përdorimi me ndarje brezi. Për të gjithë operatorët do të kenë mundësinë që të marrin pjesë në tender edhe pse aktualisht kane 3/3 e brezave të tyre të përfituar në tenderat e mëparshëm.

Nëse implementohet sa më sipër, OPERATOR 3 do të gjendet përballë skenarit të mëposhtëm:

1. Mospërfitimi (nepërmjet gares) i asnjë frekuence të vetme.
2. Përfitimi (nepërmjet gares) i një (1) frekuence të vetme FDD (2x5MHz) për OPERATOR 3 është një skenar teknikisht dhe praktikisht i pavlefshëm dhe i padobishëm sepse:
 - Shpejtesia maksimale e transmetimit të të dhënave që mund të ofrohet tek pajtimtarët është e limituar deri në 7.2 Mbps. Kjo bën të pamundur konkurrencën me operatorët ekzistues të cilët ofrojnë deri në 42 Mbps.
 - Numri i pajtimtareve që mund të shërbehen njëkohësisht në 3G është i kufizuar (3 here me pak se operatorët ekzistues).
3. Përfitimi (nepërmjet gares) i 2 frekuencave FDD (2x10MHz) është skenari minimal i pranueshëm për kushtet aktuale të pjesës së tregut që ka OPERATOR 3 por edhe për kushtet dhe mundësitë e brendshme ekonomiko-financiare të shoqërisë në mënyrë që të kryejë ofrimin e shërbimeve 3G sepse:
 - Shpejtesia maksimale e transmetimit të të dhënave do të arrijë deri në 42 Mbps, dhe kjo është mënyra e vetme për të qenë konkurrues në treg;
 - Megjithatë, Operator 3 dëshiron të mbijetojë dhe të rritet si shoqëri dhe për këtë do të dëshironim të kishim mundësinë për të pasur rezervën e frekuencës së tretë për kapacitete (ashtu siç e kanë operatorët e tjerë aktualisht).

4. Perfitimi (nepermjet gares) i 3 frekuencave FDD (3x15 MHz) eshte skenari i cili barazon OPERATOR 3 me operatoret e tjere, ashtu sic eshte zbatuar deri tani edhe per tre operatoret e tjere (te cileve iu eshte alokuar sasia prej tre frekuenca FDD).

Ne fakt nje mekanizem i tille, nese implementohet nga AKEP, rrezikon te shteroje perdorimin e frekuencave te mbetura ne brezin IMT. Si e permendem me lart, keto te fundit jane burime natyrore te kufizuara dhe perbejne barriera hyrese teknike te larta.

Duke qene se frekuencat e tjera te ketij brezi jane dhene dhe ezauruar teresisht tashme, e vetmja frekuence e lire dhe e disponueshme qe mundeson kryerjen e sherbimit 3G eshte frekuenca ne brezat 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT).

Nese:

- (i) frekuenca e mbetur copetohet duke krijuar me shume te drejta perdorimi (ndryshe nga rastet identike te meparshme te aplikuar per operatoret e tjere) dhe
- (ii) per perfitimin e ketyre te drejtave mund te konkurrojne edhe operatoret e tjere qe jane te autorizuar per te kryer sherbimin 3G (ndryshe nga rastet identike te meparshme te aplikuar per operatoret e tjere), OPERATOR 3 jo vetem giendet perpara nje barriere teknike, por kjo barriere do te behet e pakapercyeshme per te (me perjashtim te rastit kur Operator 3 perfiton te pakten 2 frekuenca FDD (2x10MHz) ose ne rastin me te mire te mundshem 3 frekuenca FDD (3x15 MHz).

Madje jo vetem kaq, por barriera teknike e mesiperme, ne rastin me te mire te mundshem per OPERATOR 3 (OPERATOR 3 merr 3 frekuenca FDD (3x15 MHz), por edhe kur merr 2 frekuenca FDD (2x10MHz), ka shume gjasa te shnderrohet ne nje barriere te larte ekonomike per shkak te cmimit eventual qe do te duhet te paguaje OPERATOR 3 per te qene perfitues i gares per marrjen e frekuencave ne fjale. Per te kuptuar kete mjafton te perdoresh nje logjike te thjeshte ekonomike dhe te veresh si eshte ulur konkretisht cmimi per marrjen e frekuencave ne fjale, kur eshte ulur numri i operatoreve qe marrin pjese ne gare. Sa me siper, me fjale te tjera, do te thote se nese AKEP implementon perfundimisht skemen e parashikuar ne Vendim, AKEP i rezervon OPERATOR 3 nje trajtim te vecante me kushte teresisht te ndryshme nga trajtimi dhe kushtet qe i ka rezervuar operatoreve te tjere ne lidhje me marrjen e te njejtit autorizim duke e diskriminuar dhe duke i ngritur barriera ekskluzive teknike dhe ekonomike.

Duke marre parasysh se Vendimi ne fjale per hapjen e ketij procesi, eshte i projektuar drejt finalizimit te nje vendimi perfundimtar te AKEP-it i cili do te krijoje, vecanerisht, barriera te renda per OPERATOR 3 (ne ndryshim nga operatoret e tjere) duke i mohuar, ne vecanti, OPERATOR 3 kushtet/te drejtat qe i jane dhene secilit prej operatoreve te tjere mund te pohohet se finalizimi i ketij Vendimi do te shtremberojte, kufizojte dhe/ose pengojte konkurrencen dhe, madje per me teper, ne vecanti, nder te tjera, do te vendose te "drejta te vecanta negative" ne sensin e kushteve te vecanta diskriminuese per Operator 3 "distorting the level playing field". Mbeshtetur ne argumentet e paraqitura me larte, dhenia e 3 frekuencave FDD (3x15 MHz) eshte nje skenar optimal per OPERATOR 3, ashtu sic eshte zbatuar deri tani edhe per tre operatoret e tjere (te cileve iu eshte alokuar sasia prej tre frekuenca FDD), por megjithate skenari minimal i pranueshem, per kushtet aktuale te pjeses se tregut qe ka OPERATOR 3 por edhe per kushtet dhe mundesite e brendshme ekonomiko financiare te kompanise ne menyre qe

te kryejë ofrimin e shërbimeve 3G, është dhënia e 2 frekuencave FDD (2x10MHz) për OPERATOR 3.

OPERATOR 4: Se pari mbështet dhe përzgjedh AKEP në lidhje me nxjerrjen për keshillim publik të dokumentit të mesipër, me besimin në zbatimin e një procesi sa më objektiv dhe transparent për nxitjen e konkurrencës efektive në treg dhe përdorimin e frytshëm të spektrit, në plotësim të kërkesave të sipërmarrësve për frekuencë dhe me qëllimin kryesor përfitimin e konsumatorëve shqiptarë.

Bazuar në situatën aktuale të rrjetit të Operator 4 dhe të sasisë së spektrit në përdorim në brezat 1.9GHz dhe 2.1GHz, Operator 4 nuk është i interesuar për marrje të drejtë përdorimi në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT) për të përdorur teknologjinë 3G. Megjithatë, pavarësisht sa më lart, nëse në Vendimin përfundimtar, AKEP do të lejojë përdorimin e teknologjisë LTE në këto breza, Operator 4 do të kërkojë ndarjen e brezit në baze të parimit të barazisë e mosdiskriminimit mes operatorëve, pra theksojmë në rast se do të lejohet përdorimi i teknologjisë LTE, brezi duhet të ndahet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët.

Qëndrimi i AKEP:

Operatorët janë dakort me propozimin e AKEP për ndarjen e spektrit. Një pjesë e argumentave të trajtuara nga operatorët do të merren në shqyrtim nga AKEP në fazat e mëtejshme të procesit.

2. Për pyetjen 2 të AKEP:

Bazuar në këte ndarje të spektrit cila është vlera që jeni gati të paguani për të drejtë?

OPERATOR 1: Vlera për dhënie të frekuencave varet nga shërbimet që mund të ofrohen në lidhje me këte të drejtë përdorimi, nga kushtet aktuale të tregut të telefonisë së levizshme si dhe nga pritshmeritë e kompanive në lidhje me zhvillimet e ardhshme në treg dhe fitimi përkatës, por gjithmone, në respekt të parimit të mos-diskriminimit dhe konkurrencës së ndershme në të cilën duhet të vihen operatorët në treg.

Frekuencat janë një burim natyror i fundem sipas nenit 62 të ligjit nr.9918, pra një pasuri publike, dhe konsiderohen si aset jo material që fitojnë një vlerë të matshme sa herë që jepen në përdorim për qëllime komerciale ose publike. Me to janë të lidhura ngushtë një sërë aktivitësh ekonomike dhe komerciale në sektorin e komunikimeve elektronike të cilat gjenerojnë të ardhura të konsiderueshme për ekonominë e një vendi. Prandaj, dhënia në përdorim të frekuencave bazohet pikërisht në karakteristikën fundamentale si burim i kufizuar me natyrë publike, dhe vlera ekonomike e tyre reflekton rendësinë e madhe të spektrit dhe përcaktimi i kesaj vlerë i shërben objektivit për përdorimin sa më eficient të spektrit të frekuencave nga paletë e interesuara. Vlera ekonomike e spektrit përfitohet nga fitimet që një operator shërbimesh mund të përfitojë nga ofrimi i aplikimeve dhe shërbimeve me vlerë duke përdorur ekskluzivisht këto frekuencë.

Meqenese ne kete brez do jepen tre te dreja perdorimi duke e ndare ate ne tre pjese te barabarta, OPERATOR 1 eshte e mendimit per nje te drejte perdorimi oferta duhet te jete jo me shume se 1 300 000 (nje milion e tre qind mije) Euro.

Edhe pse keto tre te drejta perdorimi duhet te jepen per nje afat perdorimi 15 vjet sic cdo brez tjeter qe eshte dhene ne perdorim ne zbatim te nenit 72 te ligjit per komunikimet elektronike Ligji 9918/2008 i ndryshuar, do te donim te sillnim vernendjen edhe nje here tek diskutimi aktual i draftregullores se Komisionit Evropian "Kontinent i Lidhur". Propozimet e Komisionit dhe shumica e ndryshimeve qe vijne nga komiteti drejtues i Parlamentit Evropian te Industrise (ITRE) parashikojne vecanerisht nje politike me te harmonizuar te spektrit per Evropen, rrisin spektrin per sherbimet celulare broadband dhe shtrijne afatet per autorizimet perkatese te spektrit ne te pakten 20-30 vjet.

Per me teper, sipas ligjit mbi komunikimet elektronike ne Shqiperi, neni 7/pika 1 Objektivat rregullatore: 1. AKEP ushtron funksionet ne perputhje me kete ligj dhe me aktet e tjera ligjore, si dhe ne perputhje me politikat sektoriale kombetare te zhvillimit te komunikimeve elektronike dhe me marreveshjet nderkombetare ne fushen e komunikimeve elektronike, ku Republika e Shqiperise eshte pale. AKEP merr ne konsiderate rekomandimet dhe vendimet e Komisionit Evropian dhe BEREC". Ky zhvillim eshte marre ne konsiderate tashme nga shtete te tjera (p.sh., Hungaria shtyu licensat GSM ne 22.5 vjet, dhe do te rrise afatin per spektrin e ri ne vijim deri ne 20 vjet) gjate pergatitjes se tenderave te spektrit.

Operator 2: Objektiv i AKEP ne dhenien e spektrit eshte te siguroje perdorim optimal. Cmimi i spektrit mund te perdoret si mekanizem per caktimin me efektiv te spektrit. Kjo per shkak se vendosja e cmimeve do te krijoje kosto te mbajtjes se spektrit dhe mund te beje qe perdoruesit jo eficiente te heqin dore nga marrja e spektrit nese e vleresojne spektrin me pak se cmimi i spektrit i vendosur nga jashte. Vendosja e cmimit te duhur eshte teper e rendesishme per tarifimin e spektrit, per te ndikuar ne permiresimin e caktimit eficient te spektrit: cmimi mbi nivelin e cmimit te tregut do te reduktonte eficienten ne dhenien e spektrit te perdorur. Spektri i radio frekuencave eshte nje burim natyror i fundem, me nje vlere te larte per shkak te perdorimit per qellime ekonomike dhe tregtare ne sherbimet e komunikimeve elektronike. Ne lidhje me sa me siper, spektri i radio frekuencave ka nje vlere ekonomike te matshme te lidhur me shume faktore, ndermjet te tjerash, kerkesa ne rritje per sherbime celulare me brez te gjere, kategorite e sherbimeve per te cilat do te perdoret, kerkesa per spekter nga operatoret e tjere celulare. AKEP duhet te perdore nje benchmark te caktuar per te percaktuar cmimin e pershtatshem per rezervimin e spektrit. Cmimi per rezervimin e spektrit duhet te caktohet nga AKEP duke mbajtur parasysh vleren e tregut. Operator 2 mendon se cmimi i duhur per rezervimin e spektrit (cmimi minimal i caktuar per bllokimin e spektrit) per spektrin 2.1GHz duhet te jete ndermjet €4 milione dhe €6.1 milione per secilin bllok prej 2x5MHz. Keto vlera jane percaktuar duke llogaritur cmimet e paguara per 2.1 GHz qe prej vitit 2010 ne vende te tjera duke perjashtuar Shqiperine dhe duke marre ne konsiderate numrin e popullsise ne vend dhe ARPU (cmimi mesatar per rezervimin e spektrit). Sidoqofte AKEP duhet te mbaje ne konsiderate faktin se caktimi i spektrit ka qene jo i barabarte, duke qene se per te njejtin

spekter, Operator 2ka paguar 31.4 milione Euro, OPERATOR 1 15.1 milione Euro dhe Eagle 4 milione Euro. Kjo prek konkurrencen ne tregun celular duke qene se te gjithë operatoret celulare konkurrojnë me njeri tjetrin ne te njejtin treg ne nivel pakice.

OPERATOR 3: Ne procedurat e tenderave te meparshem me objekt dhenien e autorizimeve individuale per perdorimte frekuencave ne brezin IMT ("Sherbimi 3G"), AKEP:

- (i) i ka dhene cdo operatori vetem nje te drejte perdorimi per frekuencen e brezit perkates dhe, njekoheisht,
- (ii) (ii) ka perjashtuar nga pjesemarrja ne gare operatoret qe kishin marre te drejten per perdorimin e frekuencave perkatese ne brezin IMT, ne menyre qe te bente te mundur hyrjen ne treg te operatoreve te tjere dhe per te nxitur rritjen e konkurrences, Kronologjikisht, (ne perputhje me VKM nr. 1252, date 10.09.2008) ne tenderin e pare ne vitin 2010 ku u shpall fitues Vodafone me vleren 31.400.000 Euro, kishin te drejte te merrnin pjese te kater operatoret; ne tenderin e dyte ne vitin 2011 ku u shpall fitues AMC me vleren 15.900.000 Euro, Vodafone nuk mund te merrte pjese; ne tenderin e trete te zhvilluar ne 2012 ku nuk u shpall asnje fitues, Vodafone dhe AMC nuk mund te merrnin pjese dhe i njejtë perjashtim u perserit ne tenderin e fundit ne vitin 2013 ku u shpall fitues Eagle Mobile (sot Albtelecom) me vleren 4.000.355 Euro. Lidhur me vleren qe OPERATOR 3 eshte i gatshem te paguaje per te drejten e perdorimit, qendrimi i OPERATOR 3 i shprehur edhe me pare, eshte se: vlera e brezit te frekuencave duhet te jete funksion i sasise se spektrit po aq sa dhe peshes specifike qe cdo operator ka aktualisht ne treg (kur ky brez jepet ne te njejtin kohe per operatoret) si edhe nje koeficient kohe kur jepet ne kohe te ndryshme. Pra OPERATOR 3 kerkon, qe ky cmimi te jete i diferencuar, ne menyre absolutisht propocionale me "market share" qe aktualisht ka secili nga operatoret mobile ne treg.

Qendrimi i AKEP:

AKEP ne vleresimin e cmimit minimal per te drejte perdorimi do te marre ne konsiderate propozimet e te gjithë operatoreve.

3. Per pyetjen 3 te AKEP:

Ne se do te rezultoni fitues i nje te drejte perdorimi cili do te jete qellimi i perdorimit te tij?

OPERATOR 1, nese rezulton fituese e nje te drejte perdorimi te spektrit referuar ne kete konsultim publik, do ta perdore kete spekter kryesisht per nevojat e ofrimit te sherbimeve te paraqitura ne Autorizimin e Pergjithshem dhe te listuara me poshte:

- Akses ne Internet, per telefonat celulare dhe per kompjutera
- Telefonatat video (Video Call)
- Aplikime specifike per telefona celulare,
- Aksesim internet nga portali ose jashte tij

- Telefonata bazuar ne protokoll internet (Voice over IP)
- Zgjidhjet per Biznesin (Business solutions si mobile email, etj)
- Sherbimet on-line (on-line services)
- Shebimet Machine- to - machine
- Mobile Portal
- Mobile TV, televizioni ne celular

OPERATOR 2 shprehet se parimisht do te vleresoje pjese te spektrit ne fjale persa kohe qe mundesohet rishperndarja e spektrit ekzistues, cka mundeson vazhdimesine e spektrit per teknologjite e reja qe kerkojne kapacitete me te medha se ne rastin e GSM. Teknologjite celulare broadband si psh LTE dhe HSPA perdorin bartes me te medhenj se sa teknologjia GSM. Ne teknologjine GSM, ku gjeresia e kanalit eshte prej 200 KHz, mungesa e spektrit te vazhduar nuk perben problem themelor per ofrimin e sherbimeve. Tashme, spektri po liberalizohet dhe operatoret po lejohen ta perdorin ate per cfaredo lloj teknologjie, dhe nje sere teknologjish IMT si p.sh. LTE kerkojne gjeresi kanali prej 5 MHz te vazhdueshem per perdorim eficient. Pasojat ne lidhje me kuadrin dhe politikat per menaxhimin e spektrit jane qe operatoret tanime kane nevojte per me shume gjeresi te vazhdueshme qe do t'ju mundesoje te perdore bartes me kapacitet me te larte per rrjetet me kapacitetet broadband. Prandaj, nevoja per spekter te vazhdueshem eshte bere kritike per perdorimin me eficence te tij. Per te krijuar blloqe te vazhdueshme spektri per operatoret, AKEP duhet te kryeje ri-shperndarjen e spektrit ndermjet operatoreve te licensuar per nje brez te caktuar. Ne kete rast, Operator 2 eshte e gatshme te ofroje informacion me te detajuar dhe propozime konkrete per nje ri-shperndarje te mundshme te ketij spektri, nese AKEP do te vendose per kete ne te ardhmen.

OPERATOR 3, sic eshte shprehur me lart, eshte kunder procedures se propozuar nga AKEP qe krijon hapesia per hapjen e nje tenderi publik ku mund te marrin pjese te gjithte operatoret pavaresisht faktit nese kane apo jo autorizim perdorimi per sherbimin 3G qe krijon mundesine e dhenies se me shume se nje te drejte perdorimi me ndarje brezi.

OPERATOR 3 kerkon frekuencen ne brezat 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT) qe te alokohet sipas skenarit dhe sipas metodologjise se cmimit te cituara me larte, per te ofruar Sherbimin 3G per pajtimtaret e tij, te cilet jane te vetmit qe ende nuk e gezojne kete sherbim.

4. Per pyetjen 4 te AKEP:

Ne se do te rezultoni fitues i nje te drejte perdorimi, cila eshte teknologjia qe do te aplikoni per ndertimin e rrjetit te aksesit?

OPERATOR 1, nese rezulton fituese e nje te drejte perdorimi te spektrit referuar ne kete konsultim publik, do ta perdore kete spekter per te aplikuar teknologjine UMTS, te

pakten per nje afat disa vjecar. Kjo bazuar ne kerkesat per sherbime dhe volumin gjithnje ne rritje te trafikut te te dhenave te gjeneruar nga rrjeti UMTS (ndertuar tashme nga OPERATOR 1). Ne parashikojme qe pas nje periudhe 2 vjecare, do te nevojitet qe te instalojme kapacitete te tilla ne stacionet 3G qe do te kerkojne edhe perdorimin e barteses se 4-rt ne brezin 2100MHz. Ne parashikimin afatgjate, dhe meqenese cdc sasi spektri e dhene ne perdorim do te jete neutral nga pikepamja teknologjike, OPERATOR 1 do ta kaloje ne menyre graduale spektrin ne brezin 2100MHz ne perdorim te teknologjise LTE, duke ndjekur qofte zhvillimet teknologjike si ne pajisjet e rrjetit dhe терминаlet perkatese, ashtu edhe nevojten e klienteve per sherbime te reja bazuar ne kete evoluim teknologjik.

OPERATOR 2: Duke mbajtur parasysh numrin e autorizimeve ne dispozicion ne kete raund (4), Operator 2 merr te mireqene zbatimin e neutralitetit teknologjik nga AKEP ne proces, dhe perfshirjen ne procedurat e ofertimit per te gjitha operatoret qe mund te kene interes per kapacitet spektri dhe shfrytezimin nga ana e tyre cilendo teknologji qe shohim te pershtatshme, qofte per ate ekzsituete apo te reia, per sa kohe kjo eshte teknologjikisht e mundur dhe efikase. Ne kete kuader, spektri ne fjale mund te perdoret per zgjerim kapacitetesh ne teknologjine 3G, por ekzistojne dhe zhvillime te fundit teknologjike qe shohin mundesine e perdorimit te ketij spektri ne menyre te agreguar per teknologjine LTE, ne terma afatmesem dhe afatgjate shfrytezimi. Ketu Operator 2 thekson qe gjithsesi, interesi konkret per kete spekter mbetet subjekt i rishperndarjes se spektrit ekzistues, si me lart sqaruar.

OPERATOR 3: Teknologjia qe OPERATOR 3 do te perdore per ndertimin e rrjetit te tij te aksesit per ofrimin e Sherbimit 3G, do te jete teknologjia W-CDMA(UTRA-FDD).

Qendrimi i AKEP:

Duke marre ne konsiderate argumentat e operatoreve ne kete keshillim, AKEP për kushtet teknike për autorizimin individual, propozon të aplikohen përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave per perdorimin IMT-2000.